

"Alban Sport" Sh.P.K.
NUIS K417210190
Rr. "Gjergj Legisi", Ish NUB,
Laparakë, Tiranë

VENDIM

I

ORTAKUT TE VETEM

TE

"ALBAN SPORT" SH.P.K.

Sot më datë 04.09.2012 (dy mijë e dymbëdhjetë) Z. *Pajtim Meçe*, shtetas shqiptar lindur në Tepelenë, Shqipëri me datë 28.11.1953, me banim Rr. "Kongresi i Manastirit", nr. 206, Hyrja 2, Ap. 48, Tirane, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 028374516, Ortak i Vetëm i shoqërisë "Alban Sport" Sh.P.K. nje shoqëri e regjistruar pranë Regjistrin Tregtar me vendimin nr. 31588, datë 12.05.2004 te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane, me NIPT nr. K417210190, me seli në adresën: Rr. Gjergj Legisi, Ish - UNB, Tiranë, Shqipëri), në përputhje Ligjin 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", datë 14.04.2008, dhe me parashikimet e Statutit,

VENDOSI:

1. Te miratoje transferimin e 1.500,00 (një mijë e pesëqind) aksione te zakonshme me të drejtë vote të kapitalit të shoqërisë "Klubi Sportiv Kastrioti" Sh.A, me vlere nominale prej 1.500,00 Euro (një mijë e pesëqind Euro) për aksion, të zotëruara nga shoqëria ALBAN SPORT Sh.P.K. tek "Klubi Sportiv Kastrioti" Sh.A., të cilat përbëjnë 75% të kapitalit aksionar të regjistruar të shoqërisë Klubi Sportiv Kastrioti Sh.a, – tek Blerësi: Z. Artan Djala, shtetas shqiptar, lindur me 14/06/1972, në Shen Koll, Lezhë , madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me dokument identifikimi pasaportë nr. H20614160E;
2. Te emërojë dhe autorizojë Z. Arjan Çela, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 12.06.1961, me banim në Rr. "Sh. Dishnica", Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 027883754, që në emër e për llogari të shoqërisë Alban Sport Sh.P.K.:
 - a) te nënshkruaje Marrëveshjen për transferimit të 75% të aksioneve që shoqëria "Alban Sport" Sh.p.k. zotëron pranë "Klubi Sportiv Kastrioti" Sh.a., transferim i cili do të kryhet nëpërmjet shitjes me vlerë nominale të aksioneve të "Klubi Sportiv Kastrioti" sh.a - tek blerësi Z. Artan Djala, shtetas shqiptar, lindur me 14/06/1972, në Shen koll, Lezhë , madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me dokument identifikimi pasaportë nr. H20614160E


[Signature]

"Alban Sport" Sh.P.K.
NUIS K417210190
Rr. "Gjergj Legisi", Ish NUB,
Laparakë, Tiranë

- b) të ndjekë gjithë procedurat e nevojshme për njoftim të këtij transaksioni pranë Regjistrin Tregtar shqiptar, mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) dhe depozitim ne QKR te: i) këtij vendimi të Ortakut të Vetëm për shitjen e aksioneve qe shoqëria Alban Sport Sh. P.K. zotëron tek shoqëria "Klubi Sportiv Kastrioti" Sh.A, dhe të Marrëveshjes për shitjen e aksioneve të shoqërisë se "Klubi Sportiv Kastrioti" Sh.a., si dhe te ii) autorizojë palë të treta për përmbushjen e tagrave të mësipërme.

Ortaku i Vetëm i "Alban Sport" Sh.P.K.

Z. Pajtim MEÇE



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 11008 Rep.

Nr. 3904 Kol

TAK

LIKUIDUA

PULSES

MARREVESHJE SHITJE AKSIONESH

Sot në Tiranë, më date 05/09/2012, para meje Noterit JULIAN ZHELEGU me seli ne Rr. Bletar Bayolevi Tirane, Shqipëri, u paraqiten palët e mëposhtme:

- ***ALBAN SPORT** Sh.p.k, regjistruar në Gjykatën e Tiranës me nr. Vendimi 31588, dt. 12.05.2004, dhe NIPT: K417210190 ,e përfaqësuar nga administratori Z. Arjan Cela , shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 12.06.1961, me banim pranë Rr. "Sh. Dishnica", Tiranë Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 027883754, (ne vijim "Shitësi"),
dhe
- **Z.ARTAN DJALA**, shtetas shqiptar, lindur me 14/06/1972, në Shenkoll, Lezhë , me dokument identifikimi pasaportë nr. H20614160E ,madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar,në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë "Klubi Sportiv Kastrioti" sh.a (ne vijim "Blerësi");

Se bashku ne këtë Marrëveshje referuar si "**Palët**".

Pasi verifikova statusin juridik te palëve, unë Noteri konstatova se Palët e mësipërme janë me zotësi te plote juridike dhe për te vepruar. Me vullnetin e tyre te lire dhe te plote ata kërkuan dhe ranë dakord me redaktimin e kësaj Marrëveshje, ne përputhje me legjislacionin shqiptar, sipas kushteve te mëposhtme.

Kushte Paraprake

A) Shitësi është zotërues i 1.500,00 (një mijë e pesëqind) aksione me të drejtë vote që përfaqësojnë 75% të kapitalit aksionar të shoqërisë "KLUBI SPORTIV KASTRIOTI" Sh.A., (një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e regjistruar pranë regjistrimit tregtar shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) më datë 26.08.2011, me seli pranë Qendër Krujë, rrethi Durrës, Shqipëri, me NUIS L14426201V (në vijim "Klubi Sportiv Kastrioti"), në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (në vijim "Ligji Tregtar") dhe në respektim të Statutit të

Klubit Sportiv Kastrioti, e përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Z.Arjan Cela ,një shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar pranë regjistrit tregtar shqiptar me vendimin nr. 31588 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 12.05.2004, me seli pranë Rr. "Gjergj Legisi", Ish-UNB, Tiranë, Shqipëri, me NUIS:K41721019O.(ne vijim "Shoqëria"),

- B) Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit 1500 (njëmije e peseqind)aksione, te cilat përfaqësojnë 75 % (shtatedhjet e pese për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë,*sipas Vendimit date 04/09/2012 ,Ortakut të vetëm të shoqërisë "Alban Sport" sh.p.k,*
- C) Blerësi dëshiron te blejë nga Shitësi te gjitha aksionet qe Shitësi zotëron ne Shoqëri, të barabarta me 1500 aksione , te cilat përfaqësojnë 75 % (shtatedhjet e pese për qind) te kapitalit themelor te Shoqërisë;
- D) Blerësi ka kryer te gjitha verifikimet e mundshme lidhur me kuotat qe Shitësi zotëron ne Shoqëri, si dhe me te drejtat e detyrimet qe burojnë prej tyre.

ATEHERE, duke marrë parasysh sa më lart, për të cilat palët janë dakord e nuk kanë pretendime, palët bien dakord si vijon:

Neni 1 Parashtrimet

- 1.1 Parashtrimet e mësipërme ne këtë Marrëveshje përfaqësojnë arsyet dhe vullnetin e lire te Palëve për sa i përket nënshkrimit te kësaj Marrëveshje.

Neni 2 Objekti i Marrëveshjes – Kalimi i aksioneve

- 2.1 Duke pranuar afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate, Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen prej Shitësit, aksionet e shoqërisë "Alban Sport" Sh.p.k që ajo zotëron tek "Klubi Sportiv Kastrioti" Sh.a dhe çdo të drejtë që buron prej tyre, të lira nga çdo lloj barre e kufizimi, për një sasi te barabarte me 1.500.(nje mije e peseqind) aksione, me të drejtë vote. ("Aksionet e Shitura") që përfaqësojnë 75% te kapitalit themelor të Shoqërisë.

- 2.2 Kalimi i pronësise mbi aksionet që do të transferohen nga shitësi tek blerësi do të konsiderohet i kryer në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje nga palët, dhe kryhet në përputhje me të gjithë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3

Çmimi i Shitjes

- 3.1 Blerësi, do ti paguajë Shitësit për Aksionet e Shitura, sipas kushteve dhe afateve të kësaj kontrate, çmimin total të shitjes prej 1.500.00 (njemije e pese qind Euro) ("Çmimi i Shitjes") që përfaqëson një cmim prej 1 Euro / aksion(nje) Euro për secilin aksion.
- 3.2 Çmimi i Shitjes do të paguhet nga Blerësi në favor të Shitësit, me lidhjen e kësaj Marrëveshje jashtë kësaj zyre noteriale.

Neni 4

Shpenzime

- 4.1 Taksat, tatimet dhe shpenzimet që lindin dhe rrjedhin nga kjo Marrëveshje do të paguhen nga Blerësi.

Neni 5

Deklarime dhe Garanci

- 5.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin si vijon:

- (a) Shitësi zotëron Aksionet e Shitura të lira nga çdo barre siguruese, peng, hipoteke, garanci pagese, barre mbi interesat, kufizim, opSION, e drejte parablerje, pretendim, prokure, detyrim vote apo marrëveshje tjetër në lidhje me votat, opSION blerje apo angazhime të tjera të çdo lloji (secila me poshtë "Barre").



- (b) Aksionet e Shitura nga Shitësi ne përputhje me këtë Marrëveshje, kur te transferohen tek Blerësi sipas kësaj Marrëveshje, do te jene te lira nga çdo Barre dhe te regjistruara rregullisht ne emrin e Blerësit ne Regjistrin e Shoqërisë.
- (c) Nënshkrimi i kësaj Marrëveshje dhe plotësimi nga Shitësi i kushteve dhe dispozitave te kësaj Marrëveshje e, nuk janë ne kundërshtim ose nuk përbëjnë shkelje te ndonjë kushti apo dispozite te: (i) Aktit te Themelimit ose te Statutit, ose te rregulloreve te tjera te Shitësit, ose Shoqërisë, (ii) ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, dekreti, ose vendimi te çdo gjykate apo autoriteti shtetëror, vendas apo te huaj subjekt i te cilit është ky Shitës apo Shoqëria, (iii) ndonjë marrëveshje, licence, ose angazhimi ne te cilin ky Shitës apo Shoqëria është pale, qe do te cenonte aftësinë e këtij Shitësi për te nënshkruar apo përmbushur detyrimet qe rrjedhin nga Kontrata ose (iv) me ligjin e zbatueshëm.
- (d) Nënshkrimi, dorëzimi dhe përmbushja e Marrëveshjes nuk do (a) tu japë te tretëve ndonjë te drejte, përfshire te drejtën e zgjidhjes, anulimit apo përsheptimit te zgjidhjes, ne lidhje me çdo marrëveshje, Marrëveshje apo detyrim te cituar ne këtë paragraf ose (b) te kërkojë miratimin apo aprovimin e ndonjë personi apo organi.
- (e) Asnjë garanci, deklarim apo marrëveshje e përcaktuar në këtë nen nuk do te interpretohet si kufizuese ne ndonjë mënyrë garanci, deklarime apo marrëveshje te tjera te kryera nga Shitësi.

Neni 6
Zgjidhja

- 6.1 Kjo Marrëveshje mund të zgjidhet vetëm me miratimin me shkrim të Palëve.

Neni 7
Forca Madhore

- 7.1 Mospërmbushja e detyrimeve te kësaj Marrëveshje nga ana e njëres prej palëve nuk do te konsiderohet si shkelje e kësaj Marrëveshje për sa kohe kjo mospërmbushje vjen si pasoje e një ngjarje te konsideruar Force Madhore, ne rastin kur provohet se pala e



prekur nga kjo ngjarje (a) ka marre te gjitha masat e arsyeshme parandaluese, si dhe te gjitha masat e nevojshme per te permbushur kushtet dhe afatet e kesaj marrveshje dhe (b) ka informuar palen tjetere ne menyre te menjehershme per ndodhjen e kesaj ngjarje. Force Madhore do te konsiderohet c'do urdher, rregullore, direktive e qeverise, e shpallur ne formen e ligjit apo ne tjetere menyre, apo c'do lloj sanksioni me natyre kombetare apo nderkombetare, trazire kryengritje popullore, lufte (e deklaruar ose jo), aksione terroriste ose guerrilase te grupeve apo te individeve te vecante, greva apo shqetesime te tjera te punes te kesaj natyre, zjarre, tertmete, apo cdo lloj shkakut tjetere, qe nuk varet nga vullneti i palëve ose nuk vjen si pasoje e neglizhencës se tyre dhe qe ata nuk kishin mundësi ta parashikonin.

- 7.2 Çdo periudhe kohe, brenda se cilës njëra prej palëve, bazuar ne këtë Marrëveshje, do te ndërmarrë ndonjë veprim, do te zgjatet ne një mënyrë te barabarte me periudhën e kohës ne te cilën pala e kishte te pamundur te vepronte si pasoje e Forcës Madhore. Ne rastin kur ngjarjet e Forcës Madhore zgjasin për me shume se 3 muaj rresht Palët do te jene te lira te zgjidhin ne mënyrë te njëanshme, pa asnjë penalitet, këtë Marrëveshje.

Neni 8

Te ndryshme

- 8.1 Kjo marrëveshje rregullohet dhe hartohet ne përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Te gjitha mosmarrëveshjet qe do te lindin lidhur me këtë Marrëveshje do te zgjidhen ne mirëkuptim mes palëve, dhe nëse nuk arrihet ne mirëkuptim kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.
- 8.2 Kjo Marrëveshje, përbënë te gjithë marrëveshjen midis palëve ne lidhje me çështjet objekt te saj. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet miratimit me shkrim nga te gjitha Palët.
- 8.3 Te gjitha njoftimet apo komunikimet sipas kesaj Marrëveshje, qe duhet t'ju jepen palëve ne Marrëveshje duhet te bëhen me shkrim ose do te dërgohen me faks apo postohen me poste (letër porosi me kthim përgjigje).



Adresa e Shitësit:

Rr. "Gjergj Legisi"
Ish UNB Laprake
Tirane, Shqipëri



Adresa e Blerësit


Klubi Sportiv Kastrioti
Rr. Qender, Kruje
Durrës, Shqipëri

8.4 Kjo marrëveshje nënshkruhet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila.

Unë, Noteri pasi ua lexova me zë të lartë palëve këtë Marrëveshje dhe u sigurova për identitetin e tyre konstatova se ata e gjejnë atë të rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lire dhe të plote dhe Unë i vërtetoj nënshkrimet e tyre sipas ligjit.

Per SHITËSIN

Z. Arjan Çela



Arjan Çela

BLERËSI

Z. Artan Djala

Artan Djala

NOTERI

JULIAN ZHELEGU

Julian Zhelegu

KLUBI SPORTIV KASTRIOTI SH.A.

VENDIM I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME
TE SHOQERISE KLUBI SPORTIV KASTRIOTI SH.A.

Sot me date 22 korrik 2013, ne selinë e Shoqërisë Klubi Sportiv Kastrioti Sh.a., me adrese ne Kruje (Durres) dhe Nipt L14426201V, e regjistruar si person juridik me date 26.08.2011, u mblodh Asambleja e Aksionereve te Shoqërisë, e perfaqesuar nga 100% e kapitalit te shoqërisë si vijon:

- Z. Artan Djala, qe zotëron 75% te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 1500 (njemije e peseqind) aksione me vlere nominale Leke 1000 (njëmijë//00) secila;
- Bashkia Kruje e perfaqesuar nga Z. Shkelzen Hoxha, qe zotëron 25% te kapitalit te shoqërisë i vlerësuar ne 500 (peseqind) aksione me vlere nominale Leke 1000 (njëmijë//00) secila, sipas vendimit te keshillit bashkiak, bashkangjitur;

Rendi i dites.

1. Shitjen e 24% te kapitalit te Shoqerise te zoteruara nga aksioneri Z. Artan Djala te barasvlershme me 480 aksione me vlere nominale 1000 (njemije) Leke secila me çmim Leke 480.000 (katerqinde tetedhjetemije) tek bleresi Z. Oltion Shehi.

Pas shqyrtimi te rendit te dites dhe diskutimi te gjere, asambleja e aksionereve si me sipër e perfaqesuar,

VENDOSI

1. Miratimin e shitjes se 24% te kapitalit te Shoqerise te zoteruara nga aksioneri Z. Artan Djala te barasvlershme me 480 aksione me vlere nominale 1000 (njemije) Leke secila me çmim Leke 480.000 (katerqinde tetedhjetemije) tek bleresi Z. Oltion Shehi.
2. Shoqeria Klubi Sportiv Kastrioti Sh.a, do kete si ortake:
 - Z. Artan Djala zotërues i 51% te aksioneve te kapitalit te shoqërisë, te barasvlefshme me 1020 aksione me vlere nominale Leke 1000 (njemije) secila;
 - Z. Oltion Shehi zotërues i 24% te aksioneve te kapitalit te shoqërisë, te barasvlefshme me 480 aksione, me vlere nominale Leke 1000 (njemije) secila;





- Bashkia Kruje zotëruese e 25% te aksioneve te kapitalit te shoqërisë, te barasvlefshme me 500 aksione, me vlere nominale Leke 1000 (njemije) secila.
- 3. Regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit.

Asambleja e ortakeve

Bashkia Kruje

Perfaqesuar nga

Z. Shkelzen Hoxha



Z. Artan Djala



KONTRATE SHITBLERJE AKSIONESH

Sot me date 25 korrik 2013, (dy mije e trembedhete), aksioneret e Shoqërisë Klubi Sportiv Kastrioti Sh.a., me adrese ne Kruje (Durrës) dhe Nipt L14426201V, e regjistruar si person juridik me date 26.08.2011, vendosen te nenshkruajne me vullnetin e tyre te lire dhe te pa vesuar, kontraten e shitblerjes se aksioneve si me poshtë :

PALA SHITSE:

Z. ARTAN DJALA, i biri i Ymerit, lindur ne Shenkoll Lezhe, me 14.06.1972, dhe me banim ne Tirane, shtetas shqiptar, madhor me zotësi te plote juridike për te vepruar, i identifikuar me leter njoftim nr. 030318970 i vlefshem deri me date 12.12.2020, ne vijim i quajtur Shitës.

PALA BLERESE:

Z. Oltion Shehi, i biri i Iliazit, lindur ne Kruje i datëlindjes 19.12.1975 dhe me banim ne Kruje (Shqiperi), shtetas shqiptar, madhor me zotësi te plote juridike për te vepruar, i identifikuar me leter njoftim nr. 030920325, i vlefshem deri me date 10.04.2021, ne vijim i quajtur blerësi.

Parashtruar qe:

- Me vendim te Asamblesë se Aksionareve te Shoqërisë Klubi Sportiv Kastrioti Sh.a. date 22.07.2013, është miratuar shitja e aksioneve nga aksioneri shites ne masen totale prej 24% te kapitalit te shoqerise tek blerësi Z. Oltion Shehi;

Sa me sipër u parashtrua është pjese integruese e kësaj kontrate.

Palët si me sipër me vullnetin e tyre te lire vendosin si vijon:

Neni 1 Objekti kontratës.

Aksioneri i Shoqerise Klubi Sportiv Kastrioti Sh.a. vendos ti shese bleresit aksionet si ne vijim:

- Z. Artan Djala zoterues i 75% te kapitalit te shoqerise te barasvlefshme me 1500 aksione, i shet Z. Oltion Shehi, 24% te kapitalit te shoqerise te barasvlefshme me 480 aksione, te cilat kane nje vlere nominale ne Leke 1000 (nje mije) secila.

Neni 2 Çmimi dhe pagesa.

2.1 Çmimi i caktuar për shitjen e aksioneve te shoqërisë per te cilin palet bien dakord te shesin eshte sipas vleres se kapitalit ne si vijon:

- çmimi ne total i shitjes se 24% te kapitalit i barasvlefshem me 480 aksione te zoteruara nga Z. Artana Djala eshte ne Leke 480.000 (katerqind e tetedhete mije) tek blerësi Z. Oltion Shehi;

2.2 Te dy palet si blerësi ashtu dhe shitesi deklarojne se çmimi i shitjes eshte shlyer sipas marreveshjes midis paleve dhe si pasoje, nuk kane me asnje pretendim ndaj njeri tjetrit.



Neni 3 Pronësia dhe transferimi i aksioneve.

3.1 Pala shitëse i garanton palës blerëse se aksionet janë të lira nga çdo detyrim ligjor dhe financiar ndaj të tretëve dhe për çdo pretendim që mund të ngrëne të tretet ajo është e gatshme dhe e detyruar të paraqitet me kërkesën e palës blerëse para gjithë organeve gjyqësore dhe administrative për të mbrojtur të drejtën e tij si pronar i ligjshëm i këtyre aksioneve.

3.2 Pronësia e aksioneve i transferohet blerësit në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate shitblerje. Nga ky moment blerësit i transferohet pronësia e aksioneve dhe si pasoje shoqëria Klubi Sportiv Kastrioti Sh.a. do të ketë si aksionere palet si vijojnë:

- Z. Artan Djala zotërues i 51% të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, të barasvlefshme me 1020 aksione me vlerë nominale Leke 1000 (njemije) secila;
- Z. Oltion Shehi zotërues i 24% të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, të barasvlefshme me 480 aksione, me vlerë nominale Leke 1000 (njemije) secila;
- Bashkia Kruje zotëruese e 25% të aksioneve të kapitalit të shoqërisë, të barasvlefshme me 500 aksione, me vlerë nominale Leke 1000 (njemije) secila.

Kjo kontrate u hartua në përputhje me vendimin e Aksionereve date 22.07.2013, akteve të themelimit të shoqërisë dhe në bazë të ligjit n. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Sa parashikuar në dispozitat kontraktuese të mësipërme, në përputhje me nenin 686 të Kodit Civil Shqiptar.

I bashkangjitet kësaj kontrate edhe ekstrakti i Regjistrit të Barreve Siguruese date 25.07.2013.

PALET KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE

Artan Djala


PALA BLERËSE

Oltion Shehi


Shoqeria KLUBI SPORTIV KASTRIOTI sh.a

Selia :Qender ."Kruje"

Regjistruar me

NIPT.L14426201V

Vendim

I ASAMBLESE SE AKSIONERVE

TE SHOQERISE KLUBI SPORTIV KASTRIOTI sh.a

Date 18.06.2015

Ne seline e shoqerise ,u zhvillua mbledhja e asamblese se aksionerve KLUBI SPORTIV KASTRIOTI sh.a me pjesmarrjen e aksionerve :

- 1.Oltion Shehi ,zoterues I 480 aksioneve ,te cilat perfaqesojne 24% te kapitalit te shoqerise .
 - 2.Artan Djala,zoterues I 1020 aksioneve ,te cilat perfaqesojne 51% te kapitalit te shoqerise.
 - 3.Bashkia,Kruje,zoteruese e 500 aksioneve ,te cilat perfaqesojne 25% te kapitalit te shoqerise perfaqesuar nga zoti Alban Vogli ,me autorim nga Kryetari Bashkise ,kruje,me kete rend
- Emerimin e ri te Keshillit mbikqyres
 - Emerimin e administratorit te shoqerise .
 - Miratimin e shitjes se aksioneve ,nepermjet kontrates se shitjeve te aksioneve
- Ne perfundim pas shqyrtimit te rendit te dites ,mbeshtetur ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"dhe ligjin nr 9901,date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ",mbledhje e asamblese se aksioneve,

VENDOSI

1.Shkarkimin e nga anetare te keshillit mbikqyres se anetareve 1.Shkelzen Hoxha,Arben Kumi dhe Armand Shehu.

Emerimin e keshillit te ri mbikqyres ,I cili perbehet nga tre anetar ,si me poshte :

- Ban Vathi (kryetar) nr 028348430 nr personal I60716010H
- Fation Berhami (anetar)nr 024600649 nr personal I70516007I
- Shkelzen Ristami (anetar) nr 028498440 nr personal H50322014J

2. Keshilli Mbikqyres do te ushtroje kompetencat sipas ligjit dhe statutit te shoqerise ,per nje periudhe 3 vjecare,me te drejte rizgjedheje



3. Emerimin e administratorit te ri te shoqerise Oltion SHEHI, i biri i Iljazit ,lindur ne Kruje ,me 19.12.1975 banues ne Kruje, lagja nr 1 Hoxhe,shtetas shqiptar,madhor,me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,mbajtes i leternjoftimit nr.030920325, nr personal H51219005R , i cili do te ushtroje kompetencat sipas ligjit dhe statutin e shoqerise,per nje periudhe 3 vjecare,me te drejte rizgjedhje.

4.Miratimin e shitjes se aksioneve,sipas kontrates se shitjes se aksioneve.

Autorizohet zoti Oltion SHEHI, te depozitoje kete vendim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit,per te pasqyruar ndryshimet e mesiperme ne skeden e shoqerise.

ASAMBLEJA E ASAMBLESE SE AKSIONEREVE

Oltion SHEHI

Oltion Shehi
[Signature]

Bashkia Kruje

Perfaqesuar me autorizimin nga

Alban VOGLI

Alban Vogli
[Signature]

Artan DJALA

Artan Djala
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

NR 1175 Rep

NR 545 Kol



KONTRATE SHITJE AKSIONESH

Ne Kruje sot me date 19 qershore 2015, perpara meje noteri Avdi Vathi, anetar i dhomes se Noterise Tirane, me adrese qender Kruje u paraqiten personalisht palet.

Shitesit

Artan Djala, i biri Ymerit, lindur ne Shenkollë ,Lezhe, me 14.06.1972, banues ne Shenkollë Lezhe, madhore me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit numer personal H20614160E, aksioner i shoqerise Klubi Sportiv Kastrioti SH.P.K, zoterues i 1020 aksioneve, qe perfaqesojne 51 % te kapitalit te shoqerise.

Bleresi

Oltion Shehi i biri i Iljazit, lindur ne Kruje me 19.12.1975, banues ne lagjen Deredë Dallake Kruje, shtetas shqiptar, madhore me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar mbajtes i leternjoftimit numer 030920325, numer personal H51219005R, aksioner i shoqerise Klubi Kastrioti Sh.P.K, zoterues i 480 aksioneve qe perfaqesojne 24 % te kapitalit te shoqerise.

Palet e mesiperme me kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje aksionesh si me poshte :

Shitesi Artan Djala eshte aksioner i shoqerise Klubi Sportiv Kastrioti Sh.P.K .

Zoterues i 1020 aksioneve qe perfaqesojne 51% te kapitalit te shoqerise, e cila eshte nje shoqeri tregtare shqiptare me nipt numer L14426201V.

Asambleja e aksionereve te shoqerise me vendim date 18.06.2015 , ka miratuar :

1. Transferimin nepermjet shitjes te 1020 aksioneve te zoteruara prej aksionerit Artan Djala ne shoqeri, te cilat perfaqesojne 51 % te kapitalit te shoqerise, ne favor te aksionerit Oltion Shehi

Objekti i kontrates

Shitesi Artan Djala, transferon ne kete kontrate me vullnet te lire e te plate ne perputhje me Kodin Civil te Republikes se Shqiperise, liogji numer.9901 ,date 14.04.2008 ,(per tregtaret dhe shoqerite tregtare dhe statusit te shoqerise), 1020 aksione qe perfaqesojne 51 % te kapitalit te shoqerise te zoteruar prej tij ne shoqerine Klubi Sportiv Kastrioti SH.K.P ne favor te blesit Oltion Shehu .

CMIMI I SHITJES

Shitesi shitjes se 1020 aksioneve qe perfaqesojne 51 % te kapitalit te zoteruar nga z.Artan Djala ne Shoqerine Klubi Sportiv Kastrioti SH.P.K qe transferohen nermjet kesaj kontrate ne favor te aksionerit Oltion Shehi eshte 2.448.000 (dymiljon e katerqind e dyzetetete mije lek)

Bleresi ka paguar sipas paragrafit te mesiperm plotesisht cmimin e shitjes jasht kesaj zyre noteriale dhe shitesi deklarlon se e ka marre cmimin e plote te shitjes dhe nuk ka asnje pretendim.

Garancite

Shitesi deklarlon dhe garanton se eshte i vetmi titular i ligjshem i aksioneve qe po transferohen nepermjet kesaj kontrate dhe se ajo eshte e lire nga cdo barre apo pretendim tjetër ligjor.

Hegje dore nga te drejtat

Shitesi deklarlon nen pergjegjesine e tij personale se me nenshkrimin e kesaj kontrate zhvishet nga e drejta e pronesise mbi 1020 aksioneve te zoteruara prej tij ne Shoqerine Klubi Sportiv Kastrioti SH.P.K.

Te ndryshme

Pas realizimit te ketij transferimi me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi Oltion Shehi, behet pronar i ligjshem i 1500 aksioneve me vlere te pergjithshme 3.600.000 leke qe perfaqeson 75% te kapitalit te shoqerise Klubi Sportiv Kastrioti Sh.P.K .

Kjo kontrate u hartua ne 4 ekzemplare me vlere te njejta juridike, ne gjuhen shipe .

Palet deklaruan se jane dakort me sa mesiper dhe pasi e lexuan e kuptuan, e neshkruan rregullisht kete kontrate perpara meje dhe une noteri e vertetoj ate sipas ligjit

Shitesi

Artan Djala

Artan Djala
[Signature]

Noteri

Avdi Yathi

[Signature]

Bleresi

Oltion Shehi

Oltion Shehi
[Signature]